



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:215873

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06893697

C.nr.3248/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: H.G., L.B., L.K., M.S., M.K., M.A., M.B., M.G.I., M.Xh., S.K., N.A., Sh.B., Sh.K.1., Sh.K.2., V.M., Xh.M., Z.E., A.M., D.G., M.K., Y.C., A.R., A.V., V.B., A.B.S., N.K., E.S., D.A., G.O., M.A., E.S.A., R.E. dhe E.S. që të gjithë nga Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson av. A.S. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i pagës sipas inflacionit, vlera e kontestit 19,692.43 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 24.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve: H.G., L.B., L.K., M.S., M.K., M.A., M.B., M.G.I., M.Xh., S.K., N.A., Sh.B., Sh.K.1., Sh.K.2., V.M., Xh.M., Z.E., A.M., D.G., M.K., Y.C., A.R., A.V., V.B., A.B.S., N.K., E.S., D.A., G.O., M.A., E.S.A., R.E. dhe E.S., që të gjithë nga Komuna e Prizrenit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, që paditësve në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguajë shumën dhe atë:

- Paditëses H.G.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Paditësit L.B.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Paditëses L.K.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Paditëses M.S.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.

3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësit M.K.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësit M.A.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësit M.B.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësës M.G.I.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësës M.Xh.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 9.43 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 160.34 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 487.77 euro apo në shumën e përgjithshme prej 657.54 euro.

- Padiësës S.K.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësës N.A.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësës Sh.B.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësit Sh.K.1.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësës Sh.K.2.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësës V.M.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësës Xh.M.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësit Z.E.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësës A.M.

1. Për periudhën kohore 01.09.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 57.24 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 579.70 euro.

- Padiësit D.G.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 12.06.2022, në shumën prej 263.67 euro apo në shumën e përgjithshme prej 445.47 euro.

- Padiësës M.K.

1. Për periudhën kohore 07.04.2022 - 21.11.2022, në shumën e përgjithshme prej 366.21 euro.

- Padiësës A.R.

1. Për periudhën kohore 01.10.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 2.52 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 696.70 euro.

- Padiësës A.V.

1. Për periudhën kohore 02.05.2020 - 21.11.2022, në shumën e përgjithshme prej 341.81 euro.

- Padiësës A.B.S.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 522.46 euro apo në shumën e përgjithshme prej 704.26 euro.

- Padiësit E.S.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 5.76 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 98.60 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 299.91 euro apo në shumën e përgjithshme prej 404.27 euro.

- Padiësit D.A.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 5.76 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 98.60 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 299.91 euro apo në shumën e përgjithshme prej 404.27 euro.

- Padiësit G.O.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 5.76 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 98.60 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 299.91 euro apo në shumën e përgjithshme prej 404.27 euro.

- Padiësit M.A.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 5.76 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 98.60 euro.
3. Për periudhën kohore 01.01.2022 - 21.11.2022, në shumën prej 299.91 euro apo në shumën e përgjithshme prej 404.27 euro.

- Padiësit E.S.

1. Për periudhën kohore 01.01.2020 - 31.12.2020, në shumën prej 10.08 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2021 - 31.12.2021, në shumën prej 171.72 euro apo në shumën e përgjithshme prej 181.80 euro.

Të gjitha këto shuma me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, për secilin padiës, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë më datë 09.10.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që në emër të shpenzimeve të procedurës, padiësve t'ia paguaj shumën prej 620.10 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pabazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së padiësve, përtej shumës së gjykuar

sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 19,692.43 euro, përkatësisht shuma prej 2,833.70 euro, konkretisht shuma prej 63.57 euro për secilin nga paditësit: H.G., L.B., L.K., M.S., M.K., M.A., M.B., M.G.I., M.Xh., S.K., N.A., Sh.B., Sh.K.1., Sh.K.2., V.M., Xh.M., Z.E., A.B.S., dhe AM. shuma prej 110.29 euro për paditësen M.Xh., shuma prej 29.33 euro për paditësin D.G. shuma prej 24.43 euro për paditësen M.K. shuma prej 71.13 euro për paditësen A.R. shuma prej 363.56 euro për secilin nga paditësit: E.S., D.A., G.O. dhe M.A. dhe shuma prej 0.02 euro për paditësin E.S. në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

V. KONSTATOHET e tërhequr padia C.nr.3248/2023 e datës 09.10.2023, e paditësve: Y.C., V.B., N.K., E.S. dhe R.E. që të gjithë nga Komuna e Prizrenit, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit shtesë mbi bazën e inflacionit.

A r s y e t i m

Paditësit: H.G., L.B., L.K., M.S., M.K., M.A., M.B., M.G.I., M.Xh., S.K., N.A., Sh.B., Sh.K.1., Sh.K.2., V.M., Xh.M., Z.E., A.M., D.G., M.K., Y.C., A.R., A.V., V.B., A.B.S., N.K., E.S., D.A., G.O., M.A., E.S.A., R.E. dhe E.S. që të gjithë nga Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tyre, av. A.S. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i pagës sipas inflacionit, vlera e kontestit 23,243.88 euro.

Në padi, paditësit kanë kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022, duke theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, dhe bazuar në nenin 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për periudhën kohore 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022, është në lartësi prej 704.36 euro për secilin paditës. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Me parashtrësën e datës 16.11.2023, i autorizuari i paditësve ka precizuar kërkesëpadinë, duke kërkuar që të detyrohet e paditura, në kompensimin e pagës shtesë mbi bazën e inflacionit, për periudhën kohore nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2022, në shumë prej 767.83 euro për paditësit: H.G., L.B., L.K., M.S., M.K., M.A., M.B., M.G.I., M.Xh., S.K., N.A., Sh.B., Sh.K.1., Sh.K.2., V.M., Xh.M., Z.E., A.R., A.B.S., E.S., D.A., G.O., dhe M.A., për periudhën kohore nga data 01.09.2021 deri më 31.12.2022, në shumë prej 643.27 euro për paditësen A.M. për periudhën kohore nga data 01.01.2020 deri më 12.06.2022, në shumë prej 474.80 euro për paditësin D.G. për periudhën kohore nga data 07.04.2022 deri më 31.12.2022, në shumë prej 390.64 euro për paditësen M.K. për periudhën kohore nga data 02.05.2020 deri më 31.12.2022, në shumë prej 341.81 euro për paditësen A.V. dhe për periudhën kohore nga data 01.01.2020 deri më 01.01.2022, në shumë prej 181.82 euro për paditësin E.S. dhe ka tërhequr padinë e paditësve: Y.C., V.B., N.K., E.S. dhe R.E.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 09.08.2024, ku ka theksuar se e kundërshton

në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar. Pretendimet e paditësve se iu takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësit ushtrojnë padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se iu takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të datës 16.11.2023 si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimi numër reference 300/23 i datës 14.11.2023 për paditësen H.G. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 303/23 i datës 14.11.2023 për paditësin L.B. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënësi, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 304/23 i datës 14.11.2023 për paditësen L.K. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 305/23 i datës 14.11.2023 për paditësen M.S. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 308/23 i datës 14.11.2023 për paditësin M.K. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënësi, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 333/23 i datës 14.11.2023 për paditësin M.A. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënësi, dhe më datë 15.05.2023 ka dal në pension.

Nga vërtetimi numër reference 309/23 i datës 14.11.2023 për paditësin M.B. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU

“Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënës, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 307/23 i datës 14.11.2023 për paditësen M.I. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 306/23 i datës 14.11.2023 për paditësen M.Xh. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si edukatore, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 312/23 i datës 14.11.2023 për paditësen S.K. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 311/23 i datës 14.11.2023 për paditësen N.A. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 315/23 i datës 14.11.2023 për paditësen Shy.B. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 313/23 i datës 14.11.2023 për paditësin Sh.K. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënës, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 316/23 i datës 14.11.2023 për paditësen V.M. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 317/23 i datës 14.11.2023 për paditësen Xh.M. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 318/23 i datës 14.11.2023 për paditësin Z.E. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënës, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 320/23 i datës 14.11.2023 për paditësen A.M. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si psikologe, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 328/23 i datës 14.11.2023 për paditësin D.G. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënës, dhe më datë 12.06.2022 ka dal në pension.

Nga vërtetimi numër reference 319/23 i datës 14.11.2023 për paditësen M.K. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 278/23 i datës 14.11.2023 për paditësen A.R. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU

“Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 317/23 i datës 14.11.2023 për paditësen Xh.M. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 280/23 i datës 14.11.2023 për paditësen A.V. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 277/23 i datës 14.11.2023 për paditësen A.B. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 324/23 i datës 14.11.2023 për paditësin E.S. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si punëtor teknik, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 325/23 i datës 14.11.2023 për paditësin D.A. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si punëtor teknik, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 323/23 i datës 14.11.2023 për paditësin G.O. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si punëtor teknik, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 322/23 i datës 14.11.2023 për paditësin M.A. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si punëtor teknik, dhe vazhdon të jetë.

Nga vërtetimi numër reference 330/23 i datës 14.11.2023 për paditësin E.S. i lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë SHFMU “Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënëse, dhe më datë 01.03.2022 ka dal në pension.

Nga Lista e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve: H.G., L.B., L.K., M.S., M.K., M.A., M.B., M.G.I., M.Xh., S.K., N.A., Sh.B., Sh.K.1., Sh.K.2., V.M., Xh.M., Z.E., A.M., D.G., M.K., Y.C., A.R., A.V., V.B., A.B.S., N.K., E.S., D.A., G.O., M.A., E.S.A., R.E. dhe E.S. e cila është në shumë prej 421.00 euro. Pastaj, nga Lista e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses M.Xh. e cila është në shumë prej 393.00 euro. Ndërsa, nga Lista e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se paditësit: E.S., D.A., G.O. dhe M.A., kanë koeficientin 4, kurse bazuar në Përgjigjen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nr. protokollit 4540 të datës 11.12.2023, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësve është në shumë prej 241.68 euro.

Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në

formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par. 10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për paditësit: H.G., L.B., L.K., M.S., M.K., M.A., M.B., M.G.I., M.Xh., S.K., N.A., Sh.B., Sh.K.1., Sh.K.2., V.M., Xh.M., Z.E., dhe A.B.S.

- Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.08 euro ($421 * 0.2\% = 0.84 * 12 \text{ muaj} = 10.08 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.72 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 12 \text{ muaj} = 171.72 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2022 – 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.46 euro ($421 * 11.6\% = 48.83 * 10 = 488.30$ si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është 34.18 sipas llogaritjes ($48.83/30 = 1.627 * 21 \text{ ditë} = 34.16$) = $488.30 + 34.18 = 522.46 \text{ euro}$).

Për paditësen M.Xh.

- Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 393.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 9.43 euro ($393 * 0.2\% = 0.786 * 12 \text{ muaj} = 9.43 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 393.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 160.34 euro ($393 * 3.4\% = 13.362 * 12 \text{ muaj} = 160.34 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2022 – 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 393.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 487.77 euro ($393 * 11.6\% = 45.588 * 10 = 455.88$ si dhe periudha 21 ditë të muajit

Nëntor është 31.89 sipas llogaritjes ($45.588/30 = 1.519 * 21 \text{ ditë} = 31.89$) = $455.88 + 31.89 = 487.77$ euro.

Për paditësen A.M.

- Për periudhën 01.09.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 57.24 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 4 \text{ muaj} = 57.24$ euro).
- Për periudhën 01.01.2022 – 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.46 euro ($421 * 11.6\% = 48.83 * 10 = 488.30$ si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është 34.18 sipas llogaritjes ($48.83/30 = 1.627 * 21 \text{ ditë} = 34.16$) = $488.30 + 34.18 = 522.46$ euro).

Për paditësin D.G.

- Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.08 euro ($421 * 0.2\% = 0.84 * 12 \text{ muaj} = 10.08$ euro).
- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.72 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 12 \text{ muaj} = 171.72$ euro).
- Për periudhën 01.01.2022 – 12.06.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 263.67 euro ($421 * 11.6\% = 48.83 * 5 = 244.15$ si dhe periudha 12 ditë të muajit Qershor është 19.52 sipas llogaritjes ($48.83/30 = 1.627 * 12 \text{ ditë} = 19.52$) = $244.15 + 19.52 = 263.67$ euro).

Për paditësen M.K.

- Për periudhën 07.04.2022 – 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 366.21 euro ($421 * 11.6\% = 48.83 * 7 = 341.81$ si dhe periudha 15 ditë është 24.40 sipas llogaritjes ($48.83/30 = 1.627 * 15 \text{ ditë} = 24.40$) = $341.81 + 24.40 = 366.21$ euro).

Për paditësen A.R.

- Për periudhën 01.10.2020 – 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 2.52 euro ($421 * 0.2\% = 0.84 * 3 \text{ muaj} = 2.52$ euro).
- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.72 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 12 \text{ muaj} = 171.72$ euro).
- Për periudhën 01.01.2022 – 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është

522.46 euro ($421 * 11.6\% = 48.83 * 10 = 488.30$ si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është 34.18 sipas llogaritjes ($48.83/30 = 1.627 * 21 \text{ ditë} = 34.16$) = $488.30 + 34.18 = 522.46$ euro.

Për paditësen A.V.

- Për periudhën 02.05.2020 – 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 6.72 euro ($421 * 0.2\% = 0.84 * 8 \text{ muaj} = 6.72$ euro).
- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.72 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 12 \text{ muaj} = 171.72$ euro).
- Për periudhën 01.01.2022 – 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.46 euro ($421 * 11.6\% = 48.83 * 10 = 488.30$ si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është 34.18 sipas llogaritjes ($48.83/30 = 1.627 * 21 \text{ ditë} = 34.16$) = $488.30 + 34.18 = 522.46$ euro).

Mirëpo, pasi që gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave të palëve ndërgjyqëse, gjykata në përputhje me nenin 2 par. 1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Për paditësit: E.S., D.A., G.O. dhe M.A.

- Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 5.76 euro ($241.68 * 0.2\% = 0.48 * 12 \text{ muaj} = 5.76$ euro).
- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 98.60 euro ($241.68 * 3.4\% = 8.217 * 12 \text{ muaj} = 98.60$ euro).
- Për periudhën 01.01.2022 – 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 299.91 euro ($241.68 * 11.6\% = 28.03 * 10 = 280.30$ si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është 19.61 sipas llogaritjes ($28.03/30 = 0.934 * 21 \text{ ditë} = 19.61$) = $280.30 + 19.61 = 299.91$ euro).

Për paditësin E.S.

- Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.08 euro ($421 * 0.2\% = 0.84 * 12 \text{ muaj} = 10.08$ euro).
- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.72 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 12 \text{ muaj} = 171.72$ euro).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Më konkretisht, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditësve: H.G., L.B., L.K., M.S., M.K., M.A., M.B., M.G.I., M.Xh., S.K., N.A., Sh.B., Sh.K.1., Sh.K.2., V.M., Xh.M., Z.E., dhe A.B.S., kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme numër 214/2023 të datës 05.10.2023, e ka refuzuar një kërkesë të tillë nga data 22.11.2022 deri me datë 31.12.2022, për faktin se sipas këtij mendimi, Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022, e në rastin konkret kërkesa e paditësve përfshin periudhën kohore deri me datë 31.12.2022. Pra, shuma e tërësishme e pabazuar e paditësve të lartcekur është në lartësi prej 63.57 euro për secilin nga paditësit. Pastaj, sa i përket paditëses M.Xh. gjykata ia njohu kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë të cilën e realizon paditësi dhe atë në shumën prej 421.00 euro, duke u bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020, 2021 dhe 2022, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditësit, e që është shuma prej 393.00 euro dhe jo siç është kërkuar nga paditësja në shumën prej 421.00 euro. Po ashtu, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme numër 214/2023 të datës 05.10.2023, gjykata e ka refuzuar një kërkesë të tillë nga data 22.11.2022 deri me datë 31.12.2022, për faktin se sipas këtij mendimi, Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022, e në rastin konkret kërkesa e paditësës përfshin periudhën kohore deri me datë 31.12.2022. Pra, shuma e tërësishme e pabazuar e paditësës së lartcekur është në lartësi prej 110.29 euro. Në vazhdim, sa i përket paditësit D.G., gjykata e refuzoi kërkesën e të njëjtit në shumë prej 29.33 euro, pasi që në bazë të llogaritjes së përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.01.2020 deri më 12.06.2022, shuma që i takon paditësit është në lartësi prej 445.47 euro e jo 474.80 euro sa ka kërkuar paditësi. Më tutje, lidhur me paditësen M.K. gjykata ka refuzuar një pjesë të kërkesës, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme numër 214/2023 të datës 05.10.2023, gjykata e ka refuzuar një kërkesë të tillë nga data 22.11.2022 deri me datë 31.12.2022, për faktin se sipas këtij mendimi, Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022, e në rastin konkret kërkesa e paditësës përfshin periudhën kohore deri me datë 31.12.2022. Pra, shuma e tërësishme e pabazuar e paditësës së lartcekur është në lartësi prej 24.43 euro. Pastaj, sa i përket paditësës A.R. gjykata ia njohu kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë për periudhën kohore nga data 01.10.2020 e jo nga data 01.01.2020, pasi që bazuar në vërtetimin numër reference 278/23 i datës 14.11.2023, paditësja ka filluar punën pranë të paditurës nga data 01.10.2020 e jo nga data 01.01.2020. Po ashtu, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme numër 214/2023 të datës 05.10.2023, gjykata e ka refuzuar një kërkesë të tillë nga data 22.11.2022 deri me datë 31.12.2022, për faktin se sipas këtij mendimi, Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022, e në rastin konkret kërkesa e paditësës përfshin periudhën kohore deri me datë 31.12.2022. Pra, shuma e tërësishme e pabazuar e paditësës së lartcekur është në lartësi prej 71.13 euro. Në vijim, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditësve: E.S., D.A., G.O. dhe M.A. kompensimin mbi bazën e përqindjes së

inflacionit në pagën bazë të cilën e realizojnë paditësit dhe atë në shumën prej 241.68 euro, duke u bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020, 2021 dhe 2022 dhe Përgjigja e MASHT nr. protokollit 4540 të datës 11.12.2023, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditësve, e që është shuma prej 241.68 euro dhe jo siç është kërkuar nga paditësit në shumën prej 421.00 euro. Po ashtu, bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme numër 214/2023 të datës 05.10.2023, e ka refuzuar një kërkesë të tillë nga data 22.11.2022 deri me datë 31.12.2022, për faktin se sipas këtij mendimi, Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022, e në rastin konkret kërkesa e paditësve përfshin periudhën kohore deri me datë 31.12.2022. Pra, shuma e tërësishme e pabazuar e paditësve të lartcekur është në lartësi prej 363.56 euro për secilin nga paditësit. Në fund, sa i përket paditësit E.S. gjykata e refuzoi kërkesën e të njëjtit në shumë prej 0.02 euro, pasi që në bazë të llogaritjes së përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2021, shuma që i takon paditësit është në lartësi prej 181.80 euro e jo 181.82 euro sa ka kërkuar paditësi. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtimit të padisë në këtë gjykatë (09.10.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse. Lidhur me kërkesën e palës paditëse që kamata të llogaritet si në vlerën e specifikuar në padi dhe kërkesëpadi- precizim në shumë prej 91.32 euro, të njëjtën gjykata e gjeti si të pabazuar pasi që kjo shumë e kamatës është llogaritur sipas kërkesës kryesore të specifikuar në precizimin e datës 26.12.2023, e të cilën kërkesë gjykata e ka aprovuar pjesërisht si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kundërshtimeve tjera të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit, është marrë konform nenit 449 dhe 452 par. 2 lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës paditësve, në shumë të përgjithshme prej 620.10 euro nga shuma prej 724.00 euro sa kishte kërkuar pala paditëse. Kështu, duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur, nenin 452 par. 2 të LPK-së, pasi që paditësit kanë pasur sukses vetëm pjesërisht në kërkesën e paraqitur, përkatësisht në nivel prej 85.65 %, dhe mbi këtë bazë gjykata vendosi që paditësve i takojnë shpenzimet e procedurës në shumë prej 620.10 euro, mbi bazën e suksesit të tyre në këtë kontest, përkatësisht vetëm në nivelin e suksesit lidhur me kërkesëpadinë. Më konkretisht, me rastin e llogaritjes së shpenzimeve të palës paditëse, gjykata mori parasysh pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësve, në raport me kërkesën e parashtuar në kërkesëpadi, duke e aplikuar këtë metodë edhe lidhur me shpenzimet procedurale. Pra, shuma e kërkuar e shpenzimeve procedurale nga pala paditëse është në shumë prej 724.00 euro, ndërsa niveli i përqindjes së suksesit në procedurë, përkatësisht e drejta shpenzimeve të paditësve është në shumë prej 620.10 euro.

Gjykata vendosi si në pikën nën V. të dispozitivit të aktgjykimit, duke e konstatuar të tërhequr padinë e paditësve: Y.C., V.B., N.K., E.S. dhe R.E. në përputhje me nenin 261 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2023:215873
Datë: 24.02.2025
Numri i dokumentit: 06893697

Kështu, në nenin 261 par. 2 të LPK-së theksohet që “padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”. Andaj, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet në përputhje me nenin 261 par. 2 të LPK-së, që padia e paditësve të konstatohet e tërhequr.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398, 399 dhe nenin 261 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.3248/2023, datë 24.02.2025

G j y q t a r i
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.